

Bonus për energjin elektrike, gaz natyror dhe ujë

Për faturat shtëpiake

Mund të paraqisnin kërkesën për të përfituar “Bonusin” për banesën e rezidencës vetëm klientët me certifikatën [I.S.E.E.](#) të vlefshme dhe me vlerë jo më shumë se € **8.107,50**. Për familjet me shumë antarë të cilat kanë 4 ose më shumë fëmijë kjo shumë është prej € **20.000,00**.

Nga **1 korriku 2018** është e mundur të prezantohet kërkesa për **bonus social për furnizimin me ujë**, si në rastin e furnizimit individual ashtu dhe të çentralizuar, si tregohet në modulistikë.

Në rastin e kërkesës së bonusit për **furnizimin me energji elektrike**, kërkohet që fuqia e angazhuar të jetë:

- deri në 3 KW energji elektrike për një numër personash rezident deri në 4,
- deri në 4,5 KW për një numër personash rezident më shumë se 4.

Mund të bëhet kërkesa për bonusin social për **probleme fizike** duke prezantuar certifikatën e ASL e cila dëshmon gjëndjen shëndetsore të rëndë të njërit prej antarve të trungut familjarë, të tillë sa parashikohet përdorimi i pajisjeve të nevojshme për mbijetesën e tyre.

Kërkesat duhet të prezantohen në [Sportelin Multifunksional](#) në Sheshin Dante 37, gjatë orareve të hapjes për publikun.

Kërkesa do ketë një vlefshmëri prej 12 muajsh nga njohja e përfitimit nga ana e shpërndarësit kompetent dhe duhet të prezantohet duke përdorur modulistikën përkatëse.

 [Modeli i kërkesës së Bonusit elektrik, gas ose ujë \(101.52 KB\)](#)

 [Modulari i delegimeve \(47.88 KB\)](#)

 [Shtojca ASL \(316.3 KB\)](#)

 [Modulari i deklarimit të problemit fizik \(59.98 KB\)](#)

 [Modulari i deklarimit të ndryshimit të furnizimit \(379.82 KB\)](#)

Modularit të kërkesës duhet ti bashkangjiten me **detyrim** dokumentat e mëposhtme:

1. kopia para/mbrapa e dokumentit të identitetit të kërkuesit;
2. kopia para/mbrapa e dokumentit të identitetit dhe të kodit fiskal të deleguarit të mundshëm;
3. kopia e faqes së parë të certifikatës I.S.E.E të vlefshme;
4. kopia e faturës së gazit të kërkuesit dhe/ose
5. kopia e faturës së energjis elektrike të kërkuesit dhe/ose
6. kopia e faturës së ujit të kërkuesit.

Rinovimet

Në rastin e rinovimit është e nevojshme të prezantohet modulari të cilit i bashkangjitet letra e Sgate Anci ku tregohet data e skadimit dhe dokumentacioni i mësipërm.